

CRI(2021)28
Version albanaise
Albanian version

**REKOMANDIMI NR. 9 I POLITIKËS
SË PËRGJITHSHME TË ECRI-T 9
(I RISHIKUAR)**

**PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR ANTISEMITIZMIT**

MIRATUAR MË 1 KORRIK 2021

Strasbourg, 14 shtator 2021

Lutemi, vini re se ky dokument është variant i përkthyer. Në rast dyshimi, duhet t'i referoheni versionit origjinal në anglisht ose frëngjisht.

I. Parathënie

Duke pasur parasysh Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut;

Duke pasur parasysh Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor;

Duke pasur parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe veçanërisht nenin 14 të saj;

Duke pasur parasysh Protokollin nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që përmban një klauzolë të përgjithshme për ndalimin e diskriminimit;

Duke pasur parasysh Protokollin Shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik, lidhur me kriminalizimin e akteve me natyrë raciste apo ksenofobe të kryera përmes sistemeve kompjuterike;

Duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe të gjykatave kombëtare lidhur me nxitjen e antisemitizmit dhe gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë mohimin, shtrembërimin, minimizimin, miratimin dhe justifikimin e holokaustit, si për shembull fajësimi i viktimave;

Duke sjellë në vëmendje Rekomandimin nr. 1 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t lidhur me luftën kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës; Rekomandimin nr. 2 (të rishikuar) për organet kombëtare të specializuara në luftën kundër racizmit dhe intolerancës në nivel kombëtar; Rekomandimin nr. 6 për luftën kundër përhapjes së materialeve raciste, ksenofobike dhe antisemitiste nëpërmjet internetit; Rekomandimin nr. 7 për legjislacionin e brendshëm kundër racizmit dhe diskriminimit racor; Rekomandimin nr. 10 për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në arsim dhe përmes arsimit; Rekomandimin nr. 12 për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në fushën e sportit; dhe Rekomandimin nr. 15 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes;

Duke pasur parasysh Rezolutën 2106 (2016) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për një angazhim të ripërtërirë në luftën kundër antisemitizmit në Evropë dhe Rezolutën 2309 (2019) për ruajtjen e trashëgimisë kulturore hebreje;

Duke pasur parasysh Rezolutën e Parlamentit Evropian të 1 qershorit 2017 për luftën kundër antisemitizmit, Vendimin Kuadër të Bashkimit Evropian 2008/913/JHA për luftën kundër disa formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë përmes së drejtës penale, Deklaratën e Këshillit të Bashkimit Evropian 15213/18 për luftën kundër antisemitizmit dhe për krijimin e një qasjeje të përbashkët në aspektin e sigurisë për përmirësimin e mbrojtjes së komuniteteve dhe institucioneve hebreje në Evropë, Deklaratën e Këshillit të Bashkimit Evropian 13637/20 për integrimin e luftës kundër antisemitizmit në të gjitha fushat e politikave të ndryshme dhe në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore në fushën e luftës kundër antisemitizmit;

Duke sjellë në vëmendje Konferencën e OSBE-së në Berlin për antisemitizmin në vitin 2004, Përfundimet e Kryesisë Zvicerane të Radhës së OSBE-së më 12-13 nëntor 2014, pas 10 vjetorit të Konferencës së Berlinit për antisemitizmin, si dhe Deklaratën e OSBE-së në Bazel në vitin 2014 për rritjen e përpjekjeve për luftën kundër antisemitizmit;

Duke pasur parasysh raportin për antisemitizmin të 20 shtatorit 2019 të Reporterit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për lirinë e fesë ose të besimit;

Duke pasur parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 61/255 të vitit 2007, Planin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm të vitit 2015, Planin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Vendeve Fetare të vitit 2019 dhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes të vitit 2019;

Duke sjellë në vëmendje punën e Aleancës Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA) dhe në veçanti Deklaratën e vitit 2000 të Forumit Ndërkombëtar të Stokholmit për Holokaustin, Përkufizimin e dakordësuar në vitit 2013 për mohimin dhe shtrembërimin e holokaustit, Përkufizimin e dakordësuar të vitit 2016 për antisemitizmin dhe Opinionin e ECRI-t të vitit 2020 për Përkufizimin e dakordësuar të IHRA-s për antisemitizmin;¹

Duke sjellë në vëmendje udhëzimin e vitit 2018 të UNESCO-OSBE/ODIHR me titull “Adresimi i antisemitizmit përmes arsimit”: Udhëzimet për politikëbërësit;

Duke pasur parasysh emërimin në një sërë vendesh anëtare të Këshillit të Evropës të koordinatoreve dhe këshilluesve kombëtarë për luftën kundër antisemitizmit, si dhe emërimin e një përfaqësuesi, koordinatori apo pike fokale të veçantë për këtë problem brenda Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, OSBE-së dhe Kombeve të Bashkuara;

Duke sjellë në vëmendje parimet e instrumenteve vetërregullatore të Partive Politike;

Duke sjellë në vëmendje historinë e Evropës që imponon detyrimin që të kujtojë të kaluarën dhe të qëndrojë vigjilente dhe të luftojë aktivisht kundër çdo manifestimi të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës;

Duke i bërë homazh kujtimit të viktimave të persekutimit sistematik dhe shfarosjes së hebrenjve gjatë holokaustit, si edhe të viktimave të tjera nga politikat e persekutimit racist dhe shfarosjes gjatë Luftës II Botërore;

Duke i bërë homazh hebrenjve viktimë të masakrave dhe persekutimit sistematik nën regjimet totalitare pas Luftës II Botërore, si edhe viktimave të tjera nga politika të tilla;

Duke theksuar në këtë drejtim se Këshilli i Evropës është themeluar me qëllimin e saktë që të mbrojë dhe të promovojë vlerat e përbashkëta dhe të drejta, sidomos mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, mbi të cilat është rindërtuar Evropa pas tmerreve të Luftës II Botërore;

Duke rikujtuar që lufta kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës është bërthama dhe pjesë e pandashme e mbrojtjes dhe inkurajimit të të drejtave të njeriut;

Thellësisht të bindur se lufta kundër antisemitizmit, edhe pse kërkon masa që mbajnë parasysh specifikat e tij, është element i pandashëm dhe i qenësishëm i luftës kundër racizmit dhe intolerancës;

Duke nënvizuar se antisemitizmi ka vazhduar për shekuj në mbarë Evropën;

Duke vërejtur rritjen e antisemitizmit në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe duke theksuar se kjo rritje karakterizohet edhe nga forma bashkëkohore antisemitizmi dhe nga përhapja e urrejtjes antisemitiste online;

Duke vërejtur me shqetësim tendencën në rritje të abuzimit antisemitik gjinor ndaj grave, veçanërisht atyre që janë aktive në jetën publike ose që identifikohen si hebrenj ortodoksë;

Duke vërejtur që sulmet terroriste dhe forma të tjera të dhunës kundër hebrenjve dhe institucioneve hebreje janë rritur dramatikisht që kur ECRI publikoi për herë të parë Rekomandimin nr. 9 të Politikës së tij të Përgjithshme në vitin 2004 dhe duke vërejtur që ato e kanë zanafillën mes ideologjive të ndryshme dhe fushave politike e fetare dhe se është përgjegjësia e qeverive për të mbrojtur popullsinë e tyre, pa asnjë lloj diskriminimi, kundër dëmeve;

¹ Shih Shtojcën nr. 1 (Opinionin i ECRI-t 2020) dhe Shtojcën nr. 2 (Përkufizimi i dakordësuar i IHRA për antisemitizmin, 2016).

Nisur nga fakti që manifestime të tilla shpesh janë shfaqur njëkohësisht me ngjarje bashkëkohore si situata në Lindjen e Mesme;

Duke nënvizuar se këto manifestime nuk janë ekskluzivisht veprime të grupeve marginale ose radikale, por shpesh janë dukuri të zakonshme, përfshirë këtu edhe në shkolla, ku gjithnjë e më shumë po perceptohen si dukuri të zakonshme;

Duke vërejtur përdorimin e shpeshtë të simboleve të epokës naziste dhe referimeve të Holokaustit në manifestimet aktuale të antisemitizmit;

Duke theksuar që manifestime të tilla lindin brenda grupeve të ndryshme shoqërore dhe sektorëve të ndryshëm të shoqërisë;

Duke pasur parasysh se përdorimi i internetit është rritur gjithnjë e më shumë si një mjet për përhapjen e antisemitizmit dhe se rrjetet sociale nuk kanë marrë masa efektive për të parandaluar keqpërdorimi e rrezikshëm të platformave të tyre;

Duke vërejtur se viktimat e racizmit dhe përjashtimit, në disa shoqëri evropiane, po bëhen vetë autore të akteve të antisemitizmit;

Duke konstatuar se në disa vende, antisemitizmi, edhe në format e reja, vazhdon të inkurajohet në mënyrë të hapur apo të fshehtë nga disa parti apo udhëheqës politikë dhe jo vetëm nga partitë ekstremiste, por edhe nga parti të caktuara tradicionale;

Duke pasur parasysh se perceptimet e popullsisë hebreje mes politikanëve dhe qytetarëve të tjerë ndonjëherë kanë ngjyrimë të paqëllimshme antisemitiste që përforcojnë rrezikun e përhapjes së këtyre ideve;

Me bindjen se një përgjigje adekuate ndaj fenomeneve të tilla mund të gjendet përmes përpjekjeve të përbashkëta të të gjithë aktorëve të shoqërive evropiane, përfshirë përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme, udhëheqësit fetarë, organizatat e shoqërisë civile dhe organe të tjera të rëndësishme, veçanërisht të atyre në fushat arsimore, kulturore dhe politike;

Duke nënvizuar që përpjekjet për të luftuar antisemitizmin duhet të përfshijnë zbatimin e plotë dhe efektiv të dispozitave ligjore kundër racizmit dhe diskriminimit racial ndaj të gjithë autorëve dhe në mbrojtje të të gjitha viktimave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë dispozitave kundër nxitjes së dhunës, urrejtjes dhe diskriminimit racial;

Me bindjen se përpjekje të tilla duhet të përfshijnë inkurajimin e dialogut dhe bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm të shoqërisë në nivel vendor dhe kombëtar, si edhe dialogun dhe bashkëpunimin mes komuniteteve të ndryshme kulturore, etnike dhe fetare;

Duke nënvizuar fuqimisht rolin e arsimit, dhe veçanërisht të edukimit mbi holokaustin, në inkurajimin e tolerancës dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe, rrjedhimisht, në luftën kundër antisemitizmit;

Duke nënvizuar nevojën e adresimit proaktiv të antisemitizmit nga qeveritë përmes arsimit, që të garantojnë krijimin e rezistencës së studentëve ndaj antisemitizmit dhe formave të tjera të paragjyqimit nga sistemet arsimore dhe t'i përgjigjen me efikasitet rasteve të antisemitizmit në mjediset arsimore;

Vendosi të rishikojë Rekomandimin nr. 9 të Politikës së tij të Përgjithshme për luftën kundër antisemitizmit në përputhje me udhërrëfyesin e tij për barazi efektive të hartuar me rastin e 25 vjetorit.

II. Konteksti i përgjithshëm

Komente të përgjithshme

1. Mandati i ECRI-t dhe qëllimi i këtij Rekomandimi të Politikës së Përgjithshme (GPR) është pikërisht parandalimin dhe lufta kundër manifestimeve publike të antisemitizmit. Në këtë kontekst, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se megjithëse GPR-të e ECRI-it u drejtohen autoriteteve kombëtare të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, parandalimi dhe lufta kundër antisemitizmit duhet të perceptohen dhe të kuptohen si përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të shoqërisë.
2. Këto manifestime përfshijnë diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes, mohimin dhe shtrembërimin e holokaustit, kërcënimet dhe aktet e dhunës. Sulmet antisemite variojnë nga përdhosja e varrezave, monumenteve dhe sinagogave hebraike te sulmet fizike, madje edhe në publik, kundër hebrenjve ose personave që besohet se janë hebrenj (personat që mbajnë shenja të dukshme të fesë hebraike, si kipa, janë veçanërisht të cenueshëm), deri te vrasjet dhe sulmet terroriste vdekjeprurëse.
3. Gama e autorëve të veprave antisemitike është e gjerë. Ajo përfshin neonazistët, ekstremistët e djathtë, ekstremistët fetarë, veçanërisht islamikët e dhunshëm², si dhe ekstremistë të caktuar të majtë.³ Në disa raste, ECRI ka vënë re një rritje të përpjekjeve për rehabilitim ose minimizim të regjimeve kolaboracioniste të Luftës së II-të Botërore dhe të akteve të tyre, duke përfshirë në disa raste edhe bashkëpunimin e qeverive pushtuese si pjesë e gjithë makinerisë së Holokaustit.

Zhvillimi historik i antisemitizmit⁴

4. Urrejtja kundër hebrenjve është një problem shumë vjeçar në Evropë që u shfaq gjatë antikitetit dhe u lidh gjithashtu me zhvillimet brenda krishterimit. Rrënjët moderne të antisemitizmit si formë komplekse racizmi datojnë në gjysmën e dytë të shekullit të 19të. Rritja e tendencës së atëhershme në Evropë për kategorizimin dhe tipologjizimin e fenomeneve natyrore u aplikua gjithnjë e më shumë për qeniet njerëzore e për shoqëritë dhe kulturat e tyre.⁵ Koncepti i "semitizmit" është në vetvete një shpikje raciste e asaj periudhe, e krijuar mbi terminologjinë e mëparshme gjuhësore, nga ata që zhvilluan një bazë pseudo-shkencore për urrejtjen dhe politikën e tyre për të fajësuar popullin hebre dhe gjithashtu për të stigmatizuar lëvizjet e majta dhe liberale duke i lidhur ata me hebrenjtë si hipotetikisht të huaj për vlerat dhe jetën politike të shumicës. Koncepti u rrënjos thellë në teoritë raciste dhe mbart nocione të tipareve të pandryshueshme të karakterit që të gjithë hebrenjtë kanë të përbashkët, pavarësisht kombësisë, kulturës, klasës shoqërore, gjuhës ose faktorëve të tjerë. Ndaj, ky koncept u përpoq të përcaktonte dhe të impononte, së jashtmi, një kategori statike dhe të biologjizuar të "hebrenjve" që do të përdorej në ligjërime politike, në kuadrin e shfaqur të "racës"⁶ dhe në hierarkitë racore.

² ECRI thekson kryesisht se kjo nuk duhet keqkuptuar apo keqinterpretuar në asnjë mënyrë që justifikon paragjykimin, diskriminimin apo urrejtjen kundër myslimanëve (shih gjithashtu Rekomandimin nr. 5 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t).

³ Shih Raportin Vjetor të ECRI-t 2015: § 24 dhe Raportin Vjetor të ECRI-t 2019: § 14.

⁴ Një shënim për drejtshkrimin: ECRI e shkruan termin "antisemitizëm" pa vizë në mes. Përdorimi i vizës në mes do të nënkuptonte ekzistencën e "semitizmit" të cilit mund t'i kundërvihet. Megjithatë, vetë koncepti i "semitizmit" është shpikje raciste nga ata që dëshiruan të zhvillonin një bazë të re për urrejtjen e tyre për hebrenjtë (shih tekstin kryesor).

⁵ Shih gjithashtu: ECRI (2019): Hyrja historike (Përgatitur për 25 vjetorin e ECRI-t).

⁶ Duke qenë se të gjithë njerëzit i përkasin të njëjtës specie, ECRI refuzon teoritë e bazuara në ekzistencën e "racave" të ndryshme (shih gjithashtu Rekomandimin nr. 7 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t, shënimi 1).

5. Ky proces shënoi gjithashtu një pikë të rëndësishme në historinë e urrejtjes kundër hebrenjve. Antisemitizmi nuk u kufizua më tek urrejtja e besimit hebre, por u zgjerua përmes shpikjes së “racës semitike”. Në Evropën mesjetare dhe të hershme moderne, hebrenjtë u diskriminuan, u marginalizuan dhe iu nënshtruan urrejtjes dhe dhunës, kryesisht për shkak të fesë së tyre, për shembull bazuar në akuzat për vetëvrasje ose besëtytni për shpifje gjaku. Megjithatë, një hebre i kthehen në të krishterë ose mysliman, në varësi të besimit në Evropë, nuk ishte më, të paktën në teori, objekt i këtyre formave të intolerancës.
6. Me shpikjen e “semitizmit”, nuk ishte më vetëm feja që shihej nga antisemitët si problem, por diçka që ata besonin se ishte e paracaktuar dhe e trashëguar dhe që nuk mund të ndryshohej nga individët në fjalë. Si rezultat, për shembull, regjimi socialist kombëtar (Nazist) vrau gjithashtu njerëz me prejardhje hebrenje, familjet e të cilëve ishin kthyer në të krishterë. Në sytë e atyre personave që propagandonin urrejtjen anti-hebrenjeve, “Semitizmi” zëvendësoi “Judaizmin” ose e thënë më thjesht: “gjaku zëvendësoi besimin”.
7. Antisemitizmi u përshkrua ndryshe si helm ose virus. Antisemitizmi mund të shihet ndryshe si akomodimi i një rezervuari idesh negative për hebrenjtë, i cili është rimbushur gjatë mijëvjeçarëve dhe që mund të derdhet ndonjëherë pa dashje dhe ndonjëherë me dashje. Kjo mund të ndodhë kur stereotipet për hebrenjtë kryqëzohen me probleme të tilla si funksionimi i kapitalizmit në shoqëri ose konflikti izraelito-palestinez. Prandaj, ide të tilla mund të japin përgjigje të thjeshta dhe bindëse për problemet.

Format bashkëkohore të antisemitizmit

8. Format bashkëkohore të antisemitizmit mund të ndryshojnë nga format tradicionale të paragjyimit kundër popullit hebre, por ato të dyja mund të ekzistojnë paralelisht. Në ditët e sotme, antisemitizmi mund të shprehet edhe në disa kritika të pabaza ndaj Izraelit. Për shembull, mohimi i të drejtës së hebrenjve për atdhe, mbajtja e shtetit të Izraelit në një standard sjelljeje ndryshe nga shtetet e tjera ose demonizimi i shtetit të Izraelit dhe shikimi i tij dhe popullit të tij si natyrshëm të këqij ose racistë, mund të konsiderohet antisemitike. Megjithatë, ECRI thekson fuqishëm se çdo përpjekje për të ndryshuar ose stigmatizuar si antisemitike kritikën legjitime të Izraelit dhe politikave të tij, veçanërisht ndaj popullit palestinez dhe në kontekstin e pushtimit izraelit të territoreve palestineze, do të rrezikojë përpjekjet për të luftuar antisemitizmin dhe duhet të prandaj të refuzohet.⁷

⁷ Opinioni i ECRI për Përkufizimin e dakordësuar të antisemitizmit të IHRA-s (2020): § 7.

9. Megjithëse retorika anti-izraelite vjen edhe nga grupe antisioniste, ECRI vëren se antisionizmi nuk mund të barazohet thjesht me antisemitizmin. Sionizmi është një lëvizje hebreje kombëtare politike e themeluar në fund të shekullit të 19-të si përgjigje ndaj rritjes së antisemitizmit në Evropë me qëllim emancipimin politik të pakicave hebreje dhe krijimin e një kombi-shteti hebre. Gjithnjë ka pasur prani hebreje në tokën e paraardhësve të tyre dhe dëshira për t'u kthyer si popull ishte pjesë thelbësore e ritualit të tyre të përditshëm fetar. Ky synim u arrit përfundimisht me themelimin e Shtetit të Izraelit, i cili u krijua në përputhje me Planin e Ndarjes së OKB-së për Palestinën në vitin 1948. Antisionizmi është kundërshtimi i kësaj lëvizjeje dhe i nacionalizmit hebre. Ka pasur dhe ka ende grupime të ndryshme politike dhe fetare të popullit hebre që kundërshtojnë idenë e sionizmit. Megjithatë, nuk mund të anashkalohet fakti që antisemitizmi i sotëm mund të maskohet si antisionizëm me pretendimin e të qenit një pikëpamje thjesht politike dhe jo një formë racizmi. Kjo mund të gjendet, për shembull, në mesin e individëve që, në vetvete, nuk janë kundër nacionalizmit dhe shteteve kombëtare, por vetëm ndaj një shteti-komb *hebre*. Në këtë rast, trajtimi i ndryshëm i hebrenjve dhe i aspiratave të tyre kombëtare, si dhe veçimi i popullit hebre në zbatimin e standardeve të tjera ndaj tyre, përbëjnë forma antisemitizmi. ECRI vëren se Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara i ka karakterizuar “*përpyjekjet për delegjetimimin e të drejtës së Izraelit për të ekzistuar, duke përfshirë thirrjet për shkatërrimin e tij*” si manifestim bashkëkohor i antisemitizmit.⁸
10. As antisionizmi dhe as antisemitizmi nuk janë pikëpamje monolite, por shpesh përfshijnë pozicione kontradiktore dhe heterogjene. Pranohet gjerësisht se kufiri midis këtyre dy fenomeneve nuk është i qartë. Megjithatë, mund të vërehet se ndërsa anti-sionistët nuk janë domosdoshmërisht antisemitë, shumica dërrmuese e antisemitëve janë edhe antisionistë. Në këtë drejtim, synimi i Rekomandimit të Politikës së Përgjithshme është inkurajimi dhe mundësimi i qeverive të anëtare të Këshillit të Evropës për të trajtuar me më shumë efikasitet seksionet e mbivendosura të antisionizmit dhe antisemitizmit. Për vlerësimin e komenteve ose deklaratave specifike si vetëm antisioniste apo edhe antisemitike, nevojitet vështrimi i tyre në kontekst më të gjerë (p.sh. kush i ka bërë, pse, kur, si, ku dhe për cilin audiencë). Për shembull, kjo qasje pasqyrohet edhe në Përkufizimin e dakordësuar të Antisemitizmit të Aleancës Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA).
11. Në këtë kontekst, edhe rritja e antisemitizmit si rezultat i ndikimit të disa islamistëve të radikalizuar mbi anëtarët e komuniteteve të emigrantëve, por jo ekskluzivisht mbi ta, në Evropën Perëndimore dhe më tej ka qenë shqetësuese.⁹ Në punën e tij monitoruese, ECRI ka vërejtur se sa herë që rriten tensionet pas ripërsëritjes së rasteve të dhunës në konfliktin e Lindjes së Mesme, në Evropë rriten përgjithësimet gjithëpërfshirëse kundër të gjithë hebrenjve dhe dhuna antisemitike.¹⁰ ECRI ka theksuar në mënyrë të përsëritur se shpeshherë theksi i pamjaftueshëm i vihet nevojës për diferencimin kritikës legjitime të veprimeve të Izraelit, aq sa kjo e fundit të respektohet sipas të njëjtave standarde si çdo shtet tjetër, dhe shprehjes publike të racizmit e urrejtjes ndaj popullit hebre në përgjithësi.¹¹ Dënimi publik i retorikës dhe veprimeve të këtilla raciste është shpesh i pamjaftueshëm. ECRI ka shprehur gjithashtu shqetësimin e tij për pikëpamjen e përhapur se sulmet ndaj personave ose pronës hebreje mund të konsiderohen si

⁸ Shih: Komentet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për ngjarjen e nivelit të lartë të UNESCO-s mbi fuqinë e arsimit për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit: Çështja e antisemitizmit (2018). Shih gjithashtu: Raportuesi Special i OKB-së për lirinë e fesë ose besimit (2019): § 17.

⁹ Shih për shembull: Raporti vjetor i ECRI-t 2014: § 13; Raporti vjetor i ECRI-t 2015: § 24. Megjithatë, ECRI thekson sërish se kjo nuk duhet keqkuptuar apo keqinterpretuar në asnjë mënyrë që justifikon paragjykimin, diskriminimin apo urrejtjen kundër myslimanëve (shih gjithashtu Rekomandimin nr. 5 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t).

¹⁰ Shih për shembull: Raporti vjetor i ECRI-t 2014: § 13; Raporti vjetor i ECRI-t 2018: § 16.

¹¹ Raporti vjetor i ECRI-t 2014: § 13; Raporti vjetor i ECRI-t 2016: § 21; Raporti vjetor i ECRI-t 2017: § 16.

reagime të justifikueshme ndaj politikave ose veprimeve të qeverisë izraelite.¹² ECRI nënvizon se miratimi dhe mbështetja indirekte e racizmit antisemitik duhet të dënohet dhe parandalohet fuqimisht.

12. Shembujt e formave bashkëkohore të antisemitizmit mund të përfshijnë stereotipe tradicionale dhe teori konspirative por që zbatohen në fenomenet e ditëve moderne. Shembuj të tillë përfshijnë akuzimin e "hebrenjve" për kontrollin ose minimin e sistemit financiar ndërkombëtar, strukturave të qeverisjes globale, mediave, institucioneve shtetërore, shkaktimit të luftërave dhe konflikteve të armatosura, përhapjes së qëllimshme të sëmundjeve ose të qenurit "dora e fshehur" në një sërë skenarësh të tjerë për fundin e botës. Kjo është bërë sërish e dukshme edhe me përhapjen, veçanërisht përmes mediave sociale, të teorive konspirative antisemitike në kontekstin e pandemisë Covid-19.
13. Antisemitizmi, ndonëse është formë racizmi, karakterizohet edhe nga elemente të tjera unike. Antisemitizmi ndan botëkuptimin standard racist që hedh poshtë ekzistencën e njerëzimit të përbashkët dhe, në vend të kësaj, i nën-ndan qeniet njerëzore në kategori të ndryshme "racore", të cilat zakonisht nuk shihen si të barabarta. Nocionet e ndarjeve të pangjithshme mes "neve" dhe "atyre" që janë të natyrshme në racizëm, mund të gjenden edhe tek antisemitizmi. Megjithatë, antisemitizmi pothuajse gjithmonë karakterizohet edhe nga teori konspirative qëu atribuojnë hebrenjve qëllime të caktuara të këqija dhe fuqi të fshehura. Në këtë kuptim, antisemitizmi devijon nga stereotipet e zakonshme raciste ku "tjetri" portretizohet si inferior nga natyra. Ndryshe nga kjo, paragjykimi antisemitik shpesh bazohet te supozimet e fuqive të veçanta superiore (politike, financiare, rrjete të globalizuara) që hebrenjtë dyshohen se i mbajnë dhe i përdorin kundër johebrenjve. Stereotipe të tilla shekullore përdoren për të nxitur frikë dhe urrejtje kundër hebrenjve dhe mund të mobilizohen në mënyrë fleksibël në periudha të ndryshme dhe veçanërisht në momente krize. Nga njëra anë, antisemitizmi pasqyron një sërë pakënaqësish të ndërthurura thellë dhe është shembull i një forme të ndërthurur racizmi, por, nga ana tjetër, nuk është vetëm një formë racizmi. Hebraizimi, në varësi të kontekstit, demonizohet në lidhje me shënjesit e tjerët të identitetit si statusit social (pasuria, arsimit), formimi i përgjithshëm profesional (akademikë, artistë, bankierë) ose ideologjia politike (liberalizmi, socializmi), që krijojnë në mënyrë të përshtatshme lidhjen e nevojshme për të ushqyer teoritë relevante në çfarëdolloj kohe. Siç ndodh zakonisht me teoritë e konspiracionit, vjen një moment që akuza të ndryshme kundërshtojnë njëra-tjetrën (si për shembull hebrenjtë si "kontrollues të financave globale" dhe hebrenjtë si "truri i komunizmit").
14. ECRI vëren rritjen e ngacmimit të grave hebreje, veçanërisht në internet, për shkak të gjinisë dhe fesë së tyre. Gratë politike dhe gratë që janë pjesë e jetës publike shënjestrohen, keqtrajtohen dhe kërcënohen me dhunë, madje edhe gratë ortodokse janë sulmuar fizikisht qartazi.
15. Një tjetër shembull shqetësues i formave bashkëkohore të antisemitizmit është ringjallja e mohimit dhe shtrembërimit të Holokaustit në Evropë, duke përfshirë falsifikimin me qëllim të keq të fakteve historike të Holokaustit dhe në disa raste edhe rehabilitimin e partive pro-naziste.

¹² Raporti vjetor i ECRI-t 2018: § 16.

Mohimi dhe shtrembërimi i Holokaustit

16. Përpjekjet për mohimin apo shtrembërimi e qëllimshëm të realitetit të Holokaustit synojnë të minimizojnë krimet e nacionalsocialistëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, të rehabilitojnë nazizmin dhe antisemitizmin, të zgjasin traumën e pësuar nga viktimat dhe familjet e tyre, të mohojnë identitetin e tyre si viktimat dhe të promovojnë ideologji që nxisin gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit.
17. ECRI vëren se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se mohimi i Holokaustit nuk mbrohet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në një nga disa çështjet e paraqitura para saj, ku kërkuesit ishin deklaruar se e drejta e tyre për lirinë e fjalës ishte komprometuar, ajo gjykoj se kërkuesi kishte thënë qëllimisht të pavërteta për të diskredituar hebrenjtë dhe persekutimin që ata kanë pësuar.¹³
18. ECRI vë në dukje gjithashtu se Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dënoi pa asnjë rezervë çfarëdolloj mohimi të Holokaustit dhe u kërkoi të gjitha shteteve anëtare të refuzojnë pa rezerva mohimet e Holokaustit si ngjarje historike, qoftë plotësisht ose pjesërisht, ose çfarëdolloj aktiviteti që i shërben këtij qëllimi.¹⁴
19. ECRI thekson më tej se Protokollin Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës i vitit 2003 mbi krimin kibernetik kërkon që shtetet palë të ndjekin penalisht mohimin e Holokaustit nëse vepra është kryer me qëllimin për të nxitur urrejtje, diskriminim ose dhunë në internet dhe se Vendimi Kuadër i Bashkimit Evropian i vitit 2008 u kërkon shteteve anëtare në fjalë që të ndëshkojnë gjuhën e urrejtjes dhe miratimin publik të mohimit ose banalizimit të rëndë të krimeve të gjenocidit, përfshirë Holokaustin, si vepra penale.¹⁵ Në këtë kontekst, ECRI i referohet edhe Rekomandimeve të tij të Politikave të Përgjithshme rr. 7, 9 (2004) dhe 15.
20. ECRI e mirëpret *Përkufizimin e dakordësuar të IHRA-s për mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit*, të dakordësuar nga shtetet anëtare në vitin 2013, i cili krijon kontekste ku shfaqet shtrembërimi dhe sqaron se çfarë nënkuptohet me termat.¹⁶

Përkujtimi i Holokaustit

21. Këshilli i Evropës u themelua pas Luftës së Dytë Botërore për të mbrojtur dhe promovuar vlerat e përbashkëta dhe të drejta, e në veçanti për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut.
22. Përkujtimi i vrasjes dhe shkatërrimit të planifikuar të komuniteteve hebreje si element thelbësor i përpjekjes së regjimit nazist për të pushtuar Evropën është detyrë për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, ashtu siç është edhe ruajtja dhe mbrojtja e vendeve të trashëgimisë hebraike, të cilat janë dëshmi e traditës së gjatë e jetës hebreje në Evropë.

¹³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Pastors kundër Gjermanisë (GjEDJ 2019, nr. 55225/14).

¹⁴ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nr. 61/255 (2007).

¹⁵ Vendimi kuadër i Këshillit të BE-së 2008/913/JHA i 28 nëntorit të vitit 2008 për luftën kundër disa formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë nëpërmjet ligjit penal.

¹⁶ Shih gjithashtu IHRA (2021): Njohja dhe luftimi i shtrembërimit të holokaustit – Rekomandimet për Politikën dhe Politikëbërësit.

23. Kjo detyrë u kujtua nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës në fjalimin e saj në Konferencën Ministrore të IHRA-s më 19 janar 2020, kur deklaroi se “ECRI prej shumë kohësh ka tërhequr vëmendjen për nevojën për veprim të vendosur kundër kësaj plage... përkujtimi është i rëndësishëm. Është nderim për miliona viktima të Holokaustit. Është i domosdoshëm për dinjitetin tonë. Përkujtimi është gjithashtu i rëndësishëm sepse na ndihmon të kuptojmë gjenezën e së keqes, potencialin e saj për t'u rikthyer dhe brishtësinë e demokracive tona. Është thelbësor për stabilitetin dhe paqen, për jetesën e përbashkët në Evropë”.
24. Në veçanti, ECRI ka tërhequr vëmendjen për trajnimin e mësuesve për mirëkuptimin kulturor me qëllim frenimin e manifestimeve të ndryshme të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës në Rekomandimin e tij të Politikës së Përgjithshme nr. 1 dhe se duhet t'i bëhen homazhe përkujtimit të persekutimit dhe shfarosjes së hebrenjve gjatë Holokaustit, si dhe viktimave të tjera të persekutimit e shfarosjes raciste gjatë Luftës së Dytë Botërore në Rekomandimin e Politikës së Përgjithshme nr. 9 (2004).

III. Rekomandime

ECRI vëren se nivelet e antisemitizmit dhe format që ai shprehet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme mes shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Rekomandimet e mëposhtme, që marrin në konsideratë edhe gjetjet përkatëse të punës së ECRI-t për monitorimin e vendit, nuk duhet të kuptohen si qasje "e përshtatshme për të gjitha qëllimet". Synimi i tyre është të shërbejnë si një listë veprimesh që qeveritë ftohen t'i marrin në konsideratë dhe, nëse është e nevojshme, t'i përshtaten rrethanave të vendit të tyre në bashkëpunim me komunitetet në fjalë.

ECRI rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

A. Politikat dhe koordinimi Institucional

1 - t'i japin prioritet të lartë luftës kundër antisemitizmit dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për luftimin e të gjitha manifestimeve të tij, cilado qoftë origjina;

2 - të sigurohen që masat për luftën kundër antisemitizmit të kenë gjithmonë vendin e tyre në masat për luftën kundër racizmit, si plan i veçantë veprimi ose të integrohen në një plan të përgjithshëm kundër racizmit;

3 - të sigurohen që lufta kundër antisemitizmit të realizohet në të gjithë nivelet administrative (kombëtare, rajonale dhe vendore) dhe të lehtësojnë përfshirjen në këto përpjekje të një numri të gjerë aktorësh që u përkasin sektorëve të ndryshëm të shoqërisë (politike, ligjore, ekonomike, sociale, fetare, arsimore) në këto përpjekje;

4 - të miratojnë legjislacionin që synon të luftojë antisemitizmin, i cili mban parasysh sugjerimet që përmban Rekomandimi nr. 7 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për legjislacionin e brendshëm kundër racizmit dhe diskriminimit racial;

5 - të sigurojnë përfshirjen e parimit të ndërsektorialitetit në të gjitha politikat e barazisë, veçanërisht në ato që lidhen edhe me antisemitizmin, për të shmangur diskriminimin me bazë kombinimin e karakteristikave të mbrojtura;

6 - sipas rastit, të caktojnë koordinatorë kombëtarë dhe koordinatorë në nivel të decentralizuar që të mbikëqyrin dhe koordinojnë përpjekjet për luftën kundër antisemitizmit dhe që të cilët do të veprojnë si urë lidhëse mes qeverisë, agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera publike përkatëse (për shembull në fushën e arsimit dhe kulturës) dhe komuniteteve e institucioneve hebraike e që të cilët do të koordinohen edhe me koordinatorë të tjerë kombëtarë që të sigurojnë zbatimin e politikave të koordinuara të qëndrueshme nga shtetet anëtare;

7 - të përfshijnë plotësisht organet kombëtare të barazisë në procesin e kundërvënies, monitorimit, mbledhjes së të dhënave, dëgjimit dhe shqyrtimit të ankesave dhe peticioneve për aktet antisemitike, si dhe këshillimin e autoriteteve legjislative për miratimin e legjislacionit përkatës, sipas linjave të përcaktuara në Rekomandimin nr. 2 të Politikës së Përgjithshme të rishikuar të ECRI-t për organet e barazisë për të luftuar racizmin dhe intolerancën në nivel kombëtar;

8 - për shtetet anëtare që ende nuk e kanë bërë, të nënshkruajnë dhe ratifikojnë Protokollin Shtesë të vitit 2003 për kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike të Konventës së Këshillit të Evropës për krimin kibernetik;

9 - të mbështesin koordinimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e parandalimit dhe luftimit të antisemitizmit ndërmjet organizatave të ndryshme në nivel ndërkombëtar, si Këshilli i Evropës, OSBE, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara;

B. Parandalimi/Arsimimi

10 - të inkurajojnë eksponentët politikë dhe opinionistët që të mbajnë qëndrim publikisht dhe fuqimisht kundër antisemitizmit, duke dënuar¹⁷ çdo rast në të cilat manifestohet, përfshirë të gjitha format aktuale, si edhe të deklarojnë qartazi se antisemitizmi nuk do të tolerohet;

11 – të inkurajojnë dhe mbështesin projektet kërkimore dhe monitorimin e pavarur të antisemitizmit;¹⁸

12 - të marrin parasysh Përkufizimin e dakordësuar të IHRA-s për Antisemitizmin si mjet joligjor për të kuptuar dhe identifikuar shprehjet e antisemitizmit, duke përfshirë format bashkëkohore, në përputhje me Opininionin e ECRI-t në këtë dokument;¹⁹

13 - të sigurojnë që agjencitë e drejtësisë penale të mbledhin të dhëna për incidentet dhe krimet antisemitike në formë të disagreguar të dakordësuar si praktika më e mirë nga agjencitë evropiane dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, në mënyrë që të ofrojnë të dhëna të qëndrueshme dhe të vazhdueshme të përshtatshme për politikën e reduktimit të krimit;²⁰

14 - të rregullojnë kompanitë e internetit, duke përfshirë rrjetet e mediave sociale, operatorët e telekomit dhe ofruesit e shërbimeve të internetit, në mënyrë që të vendosen sisteme efektive për të monitoruar dhe ndaluar gjuhën e urrejtjes antisemitike në internet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;

15 - të sigurojnë trajnime të vazhdueshme në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar për oficerët e policisë, prokurorët dhe gjyqësorin për parandalimin dhe luftën kundër antisemitizmit, duke përfshirë njohjen dhe regjistrimin e krimit antisemitik të urrejtjes, të dakordësuar si praktika më e mirë nga agjencitë evropiane dhe organizata të tjera ndërkombëtare;²¹

16 - të inkurajojnë mësimin e jetës dhe historisë së hebrenjve dhe të kontributit pozitiv që personalitete të komunitetit hebre dhe kulturës hebreje kanë dhënë për shoqëritë evropiane, duke marrë në konsideratë vendet e trashëgimisë hebreje kurdo të jetë e përshtatshme;

17 - të bashkëpunojnë me të gjithë aktorët përkatës dhe komunitetin hebre me synim përfshirjen e një moduli specifik për antisemitizmin në politikën e integritetit dhe përfshirjes dhe në aktivitetet që synojnë edukimin qytetar;

18 - të sigurojnë që drejtorët e shkollave, mësuesit dhe personeli mbështetës të informohen përkatësisht për të trajtuar me efikasitet ngacmimet dhe sulmet antisemitike që ndodhin në shkolla dhe institucione të tjera arsimore, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë, përmes trajnimeve dhe materialeve të hartuara qëllimisht;

19 - të planifikojnë aktivitete arsimore përkatëse dhe efektive me qëllim që (i) të kuptojnë më mirë antisemitizmin, (ii) të parandalojnë antisemitizmin përmes arsimit, (iii) të edukojnë nxënësit dhe studentët rreth antisemitizmit dhe (iv) t'u përgjigjen incidenteve antisemitike;²²

20 - të sigurojnë që përpjekjet arsimore për të parandaluar dhe luftuar antisemitizmin përfshijnë si rezultate kryesore mësimi (i) aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, (ii) rezistencën kundër antisemitizmit, (iii) aftësinë për të kontekstualizuar antisemitizmin dhe për të sfiduar paragjykimet dhe stereotipet antisemitike, dhe (iv) empatinë për viktimat e antisemitizmit;

¹⁷ Shih gjithashtu Rekomandimin nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, veçanërisht rekomandimin 4.g

¹⁸ Shih gjithashtu Rekomandimin 23 më poshtë.

¹⁹ Opinioni i ECRI për Përkufizimin e dakordësuar të antisemitizmit të IHRA-s (2020), në veçanti § 7

²⁰ Shih për shembull Instrumentin e Informacionit të OSBE/ODIHR kundër krimeve të urrejtjes.

²¹ Shih gjithashtu programet e OSBE/ODIHR me titull "Trajnimi kundër krimeve të urrejtjes për zbatimin e ligjit (TAHCLE) dhe Trajnimi për prokurorët dhe për krimet e urrejtjes (PAHCT).

²² Shih UNESCO dhe OSBE/ODIHR (2018): Adresimi i Antisemitizmit përmes arsimit – Udhëzimet për politikëbërësit, f. 9-10.

21 – të përfshijnë edukimin rreth antisemitizmit në deklaratat e misionit të institucioneve arsimore, planet përkatëse të veprimit, kurrikulat dhe kodet e sjelljes; dhe të zhvillojnë metodologji e materiale arsimore me cilësi të lartë, si tekste shkollore dhe mjete dixhitale për këtë temë;²³

22 - të sigurojnë që edukimi për antisemitizmin të përfshihet në të gjithë disipinat përkatëse për të gjithë nxënësit dhe studentët në moshën e duhur, në arsimin formal dhe joformal, duke përfshirë arsimin e të rriturve dhe trajnimin e mësuesve²⁴ duke lehtësuar, mbështetur, monitoruar dhe vlerësuar edukimin antisemitist;

23 - të mbështesë kërkimin shkencor që synon mbështetjen e individëve dhe grupeve që rrezikojnë veçanërisht të jenë viktimat të antisemitizmit dhe të përdorin tregime të bazuara të përvojat bashkëkohore të antisemitizmit të artikuluar publikisht, përveç dokumentacionit të disponueshëm historik;

24 – të promovojnë mësimin rreth holokaustit dhe të zhvillimeve që kanë çuar në krijimin e tij në shkollë, në arsim në përgjithësi, dhe të sigurohen që mësuesit zotërojnë trajnim adekuat për ta trajtuar këtë temë, në mënyrë që të bëjnë fëmijët dhe nxënësit të reflektojnë edhe mbi rreziqet aktuale dhe mënyrat e parandalimit të ngjarjeve të tilla,²⁵ duke përfshirë vizitat e vendeve përkujtimore, ku ata ekzistojnë.

25 - të përkujtojnë zyrtarisht 27 janarin si Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, siç rekomandohet nga nisma e Ministrave të Arsimit të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës në tetor të vitit 2002 dhe Rezoluta 60/7 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e nëntorit të vitit 2005;

26 - të inkurajojnë studimin dhe kërkimet për masakrat dhe persekutimin sistematik që pësuan hebrenjtë dhe persona të tjera nën regjimet totalitare pas Luftës II Botërore;

27 - t'i kushtojnë vëmendje të veçantë nevojës për ndërgjegjësimin e publikut në kontekstin e kthimit të pronave për individët ose komunitetet hebrenj në mënyrë që të shmangët rritja e ndjenjave antisemitike, stereotipeve ose gjuhës së urrejtjes;

28 - të inkurajojë debatin brenda profesioneve të medias mbi rolin e tyre në luftën kundër antisemitizmit, dhe mbi përgjegjësinë e veçantë të profesionistëve të medias; në këtë kontekst, për të raportuar mbi të gjitha ngjarjet botërore, veçanërisht në lidhje me Shtetin e Izraelit, politikën e tij në territoret e pushtuara dhe marrëdhëniet e tij me fqinjët, në një mënyrë që shmang vijueshmërinë e stereotipeve dhe paragjyqimeve antisemitike;

29 – të mbështesin aktivitetin e organizatave joqeveritare, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër antisemitizmit dhe në inkurajimin e pranimin të diversitetit;

30 - të mbështesin veprimet e përbashkëta antiraciste përmes komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare dhe të promovojnë dialogun dhe tolerancën ndërkulturore dhe ndërfaqetare përmes përpjekjeve të qëndrueshme dhe shtrirjes madhore që përfshijnë një gamë të gjerë aktorësh shoqërorë në të gjitha nivelet, duke përfshirë sigurimin e financimit dhe krijimin e forumeve përkatëse institucionale;

31 - të sigurojnë që personat e besimit hebraik të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e fesë pa diskriminim, duke përfshirë edhe institucionet publike që parashikojnë në praktikë e tyre të përditshme përshtatjen e arsyeshme të kërkesave fetare;

32 - të inkurajojnë udhëheqësit fetarë në të gjitha nivelet që të marrin përgjegjësi për mësimet në nivelin bazë dhe të shmangin nxitjen e antisemitizmit;

²³ Shih gjithashtu Rekomandimet 16, 24 dhe 26; si dhe UNESCO e OSBE/ODIHR (2020): Adresimi i Antisemitizmit në shkollë: Kurrikula e trajnimit. Shih gjithashtu Kuadrin Referencë të Këshillit të Evropës të Kompetencave për Kulturë Demokratike.

²⁴ Shih gjithashtu Rekomandimin 24 më poshtë.

²⁵ Shih gjithashtu UNESCO (2017): Edukimi rreth Holokaustit dhe parandalimi i gjenocidit: Një udhëzues politikash:

33 - inkurajojnë të gjitha organet sportive lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që të promovojnë veprime kundër antisemitizmit dhe të gjitha manifestimeve të racizmit, në ngjarjet sportive dhe në publikimet e tyre;

34 - të dënojnë veprimtaritë që nxisin bojkotin ndaj shtetit të Izraelit, shtetasve të tij ose kompanive dhe institucioneve izraelite, nëse aktivitetet e tilla nxisin dhunë, urrejtje ose intolerancë;²⁶

C. Mbrojtja

35 - të sigurojnë mbrojtjen e hebrenjve, komuniteteve hebraike dhe institucioneve të tyre duke nxitur bashkëpunimin mes tyre dhe autoriteteve vendore e kombëtare të zbatimit të ligjit dhe sigurisë, duke njohur njëkohësisht përgjegjësinë parësore të shtetit, bazuar në praktikën dhe udhëzimet më të mira të vendosura; si dhe të vlerësojnë masat e marra e të shkëmbejnë praktikën më të mira me qeveritë e tjera;²⁷

36 - të përmirësojnë bashkëpunimin me komunitetet hebraike për të përcaktuar dhe zbatuar masat e nevojshme të sigurisë, si dhe për të siguruar mbështetjen financiare për ato masa. Sipas rastit, të ndërmarrin çdo hap të nevojshëm për të kontribuar aktivisht në garantimin e sigurisë së personave hebrenj, ndërtesave fetare, arsimore dhe kulturore, vendeve të përkujtimit dhe jetës së komunitetit hebre, në bashkëpunim dhe dialog të ngushtë me shoqatat hebraike dhe të tjerët të përfshirë në luftën kundër antisemitizmit;²⁸

37 - të sigurojnë mbështetje për viktimat e akteve antisemitike dhe të të gjitha akteve të tjera raciste, sipas instrumenteve ekzistuese ligjore,²⁹ udhëzimeve³⁰ dhe praktikave të mira, si zhvillimi i një qasjeje me në qendër viktimat; të sigurojnë që viktimat e krimit të urrejtjes të trajtohen me ndjeshmëri dhe të marrin mbështetjen e duhur (përfshirë këshillimin psiko-social) para, gjatë dhe pas procedimeve penale; të krijojnë rrjete të përbëra nga të gjithë ata që punojnë për të parandaluar dhe trajtuar diskriminimin e anëtarëve të komunitetit hebre;³¹

38 - të sigurojnë që viktimat e diskriminimit antisemitik të jenë të vetëdijshme për mundësinë e referimit të rasteve në organin kombëtar të barazisë;

39 - të sigurojnë që viktimat e akteve antisemitike të jenë të vetëdijshme për të drejtat e tyre për zhdëmtim përmes procedimeve civile, administrative dhe penale dhe të mos pengohen t'i ushtrojnë ato për shkak të frikës, njohurive të pamjaftueshme, pengesave fizike ose emocionale ose mungesës së mjeteve;

40 - të shmangin intervistimin e viktimave dhe të përdorin teknologji dhe mjete të tjera për t'i mbrojtur ato nga riviktimizimi;

²⁶ Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në çështjen Baldassi dhe të tjerët kundër Francës, në të cilën Gjykata u shpreh se nxitja e bojkotit për arsye politike mbrohet nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Liria e Shprehjes) për sa kohë që nuk nxit dhunë, urrejtje ose intolerancë (GJEDNJ 2020, nr. 15271/16; shih në veçanti § 79). Në këtë kontekst, shih edhe vendimin e GJEDNJ-së për çështjen Willem kundër Francës (GJEDNJ 2009, nr. 10883/05; në veçanti §§ 34-42).

²⁷ Shih për shembull projektin e OSBE/ODIHR "Të kthejmë fjalët në vepra për të adresuar antisemitizmin" dhe OSBE/ODIHR (2017): Kuptimi i krimeve të urrejtjes antisemitike dhe adresimi i nevojave të sigurisë së komuniteteve hebraike: Një udhëzues praktik.

²⁸ Shih edhe Deklaratën e Këshillit të BE-së për integrimin e luftës kundër antisemitizmit në fushat e politikave (2020) dhe Deklaratën e Këshillit të BE-së për luftën kundër antisemitizmit dhe zhvillimin e një qasjeje të përbashkët sigurie për të mbrojtur më mirë komunitetet dhe institucionet hebraike në Evropë (2018).

²⁹ Shih për shembull Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (1983).

³⁰ Shih për shembull Udhëzimet e Rishikuara të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Viktimave të Akteve Terroriste (2017).

³¹ Shih Përmbledhjen e praktikave për krimin e urrejtjes BE-FRA

D. Prokuroria/Zbatimi i ligjit

41 - të sigurojnë që legjislacioni u mundëson agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të prokurorisë të luftojnë me efikasitet antisemitizmit, duke marrë parasysh rekomandimet e ECRI-t në Rekomandimin e Politikës së Përgjithshme nr. 7 për legjislacionin kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racor;

42 - të sigurohen që legjislacioni të parashikojë që për të gjitha veprat penale, motivi racist të përbëjë rrethanë rënduese dhe që motivi antisemit të përfshihet si rrethanë rënduese;

43 - të sigurohen që e drejta penale në fushën e luftës kundër racizmit të përmbajë dispozita për antisemitizmin dhe që i cilëson vepra penale akte antisemite më poshtë, nëse kryhen me dashje:

- a. gjenocidin, diskriminim racor ose veprat raciste;
- b. përgatitjen për gjenocid, diskriminim racor ose vepra raciste;
- c. nxitje publike për dhunë, urrejtje apo diskriminim ndaj një personi apo grupi personash mbi bazën e identitetit apo origjinës së tyre hebreje;
- d. ushtrimin e dhunës ndaj një personi tjetër ose dëmtimin e pronës së tij/saj për shkak të identitetit ose origjinës së tij/saj aktuale ose të supozuar hebraike;
- e. krijimin ose udhëheqjen e një grupi që i ka vënë vetes qëllimin të propagandojë ose të nxisë diskriminim, dhunë ose urrejtje, ose ushtrimin e dhunës kundër një personi tjetër apo dëmtimin e pronës së tij/saj për shkak të identitetit ose origjinës së tyre hebraike;
- f. anëtarësimin në një grup ose organizatë që i vendos vetes objektivat e përmendura në pikën e) më sipër;
- g. Pjesëmarrjen në një sulm në grup kundër një pjese të popullsisë, qytetarëve individualë ose pronës së tyre në lidhje me identitetin ose origjinën e tyre reale ose të supozuar hebreje;
- h. fyerjet dhe shpifjet publike ndaj një personi apo grupi personash mbi bazën e identitetit apo origjinës së tyre hebreje reale apo të supozuar;
- i. kërcënimet ndaj një personi apo grupi personash mbi bazën e identitetit apo origjinës së tyre hebreje reale apo të supozuar;
- j. shprehja publike, me qëllim antisemit, të një ideologjie që zhvlerëson apo denigron një grup personash mbi bazën e identitetit apo origjinës së tyre hebreje;
- k. glorifikimi, mohimi, shtrembërimi, minimizimi, justifikimi apo miratimi publik i Holokaustit;
- l. shprehja publike e glorifikimit, mohimit, shtrembërimit, minimizimit, miratimit apo justifikimit, me qëllim antisemit, të krimeve të gjenocidit, krimeve ndaj njerëzimit apo krimeve të luftës të kryera ndaj personave mbi bazën e identitetit apo origjinës së tyre të vërtetë apo të supozuar hebreje;
- m. përhapja apo shpërndarja publike, prodhimi apo mbajtja me synim përhapjen apo shpërndarjen në publik, me qëllim antisemit, të materialeve të shkruara, imazheve apo çfarëdo materiali që përmban manifestime të ideve dhe teorive që përcaktohen në germat më lart c), h), i), j), k) dhe l);
- n. përdhosjen, shkatërrimin ose dëmtimin me qëllim antisemitik të sinagogës, shtëpisë së lutjes, shenjtërores, vendit të përkujtimit ose institucioneve të tjera të komunitetit hebre, si shkollat, qendrat kulturore ose varrezat, ose simbolet e tyre;
- o. pengimin me forcë ose kërcënimin e hebrenjve për praktikimin e lirishëm të besimit të tyre ose të kryerjes së ritualeve dhe shërbimeve të tyre fetare, të cilat nuk cenojnë ligjet e vendit, rendin publik dhe moralin;

44 - të sigurohet që krimet antisemitike të kryera në internet të ndëshkohen njësoj si krimet offline dhe të adresohen përkatësisht përmes ndjekjes penale efektive dhe masave të tjera. Gjuha e paligjshme antisemitike e urrejtjes duhet të hiqet menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme nga ofruesit e shërbimeve të internetit, në përputhje me kuadrin përkatës ligjor dhe joligjor;

45 - të sigurohen që legjislacioni të parashikojë detyrimin për ndalimin e financimeve publike për organizatat që inkurajojnë antisemitizmin, përfshirë në këtë rast partitë politike;

46 - të sigurohen që legjislacioni të parashikojë mundësinë e shpërbërjes së organizatave që inkurajojnë antisemitizmin;

47 - të marrin masat e përshtatshme për të garantuar që legjislacioni i destinuar për parandalimin dhe ndëshkimin e antisemitizmit të zbatohet me efektivitet;

48 - të zbatojnë rekomandimet e bëra në seksionin III.B (Parandalimi/Arsimimi) më sipër për mbledhjen e të dhënave (§ 13) dhe trajnimin për oficerët e policisë, prokurorët dhe gjyqësorin (§ 15);

49 - të zbatojnë rekomandimet e bëra në seksionin III.C (Mbrojtja) më sipër për të drejtat e viktimave (§ 39) dhe shmangien e riviktimizimit (§ 40);

50 - të nxisin pjesëmarrjen efektive të viktimave të akteve antisemitike në procedimet civile, administrative ose penale, në përputhje me procedurat e vendit;

51 - policia dhe shërbimet e prokurorisë duhet të caktojnë persona kontakti për grupet vulnerabël të shënjestruara nga gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, përfshirë ato antisemite. Personat e kontaktit duhet të marrin trajnime të vazhdueshme për hetimin e gjuhës së urrejtjes dhe krimeve, si dhe duhet të ndërtojnë dhe mbajnë dialog të rregullt me këto grupe për të siguruar raportim, hetim dhe ndjekjen e duhur të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes;

52 - policia dhe shërbimet e prokurorisë duhet të hetojnë plotësisht të gjitha rastet e krimet të supozuar antisemitik të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe duhet të sigurojnë që ekzistenca e mundshme e motivimit të njëanshmërisë të merret vazhdimisht në konsideratë në raportet dhe hetimet e policisë, si dhe në çdo procedurë të mëtejshme gjyqësore.

SHTOJCA I

Opinionimi i ECRI-t për Përkufizimin e Dakordësuar të IHRA-s për antisemitizmin (miratuar në mbledhjen e 84-të plenare të ECRI-t, më 2 dhjetor 2020)

1. ECRI vëren se aktualisht nuk ka një përkufizim përfundimtar dhe absolut të antisemitizmit. Diskutimet akademike kanë pasqyruar një gamë të gjerë qasjesh të ndryshme, por pa rezultat përfundimtar.
2. Në vitin 2004, Qendra Evropiane e Monitorimit të Racizmit dhe Ksenofobisë (EUMC, paraardhëse e Agjencisë për të Drejtat Themelore të BE-së – FRA) hasi probleme në përpilimin e saktë të të dhënave për incidentet antisemitike për shkak të mungesës së plotë ose të pjesshme të monitorimit zyrtar shtetëror në këtë fushë. Udhëzimet, nëse kishte, për regjistrimin e incidenteve të tilla shpesh ishin të paqarta, gjë që çoi në raportim të ulët të policisë dhe autoriteteve të tjera përkatëse. Luftimi i rritjes së problemit të antisemitizmit në Evropë u pengua shumë nga mungesa e një përkufizimi operacional që të mund të përshkruante në mënyrën e duhur format tradicionale të antisemitizmit, me origjinën e tyre në teoritë politike racore, fetare, ekonomike dhe ekstremiste, si dhe në forma të ndryshme bashkëkohore antisemitizmi të shprehura si zhvlerësimi i Izraelit si shtet hebre, por që maskohej thjesht si antisionizëm. Për ta korrigjuar situatën, EUMC doli me një përkufizim të dakordësuar me përfaqësuesit e organizatave hebraike dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Përkufizimi i dakordësuar nuk është krijuar për t'u ligjëruar, por për të dhënë udhëzime operacionale për autoritetet përkatëse publike. Përkufizimi i dakordësuar i EUMC-së siguroi bazën e punës së mëtejshme në këtë fushë, megjithëse nuk u miratua përfundimisht për faktin se as EUMC, as pasardhësi i saj FRA, nuk ishin organe që përcaktojnë standarde, por agjenci kërkimore që këshillonin Komisionin e Bashkimit Evropian.
3. Më pas, në vitin 2016, Aleanca Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) miratoi përkufizimin e dakordësuar jo-ligjor të detyrueshëm të antisemitizmit, i cili bazohet kryesisht te puna e mëparshme e EUMC-së. Që atëherë, përkufizimi i dakordësuar ka fituar mbështetje në komunitetin ndërkombëtar dhe është miratuar nga 27 shtete (që nga nëntori 2020), duke përfshirë 23 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe është miratuar ose rekomanduar për përdorim nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë, si p.sh. si Raportuesi Special i Bashkimit Evropian dhe i Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Fesë dhe Besimit.
4. Megjithatë, për këtë përkufizim të dakordësuar ka pasur edhe kritika. Ndër të tjera, është argumentuar se përkufizimi i dakordësuar nuk pasqyron konsensusin brenda njohurive akademike. Megjithatë, të tjerë theksuan se përkufizimi i dakordësuar nuk ishte hartuar si ushtrim akademik dhe duhet kuptuar si mjet operacional.
5. Një kritikë tjetër është se përkufizimi i dakordësuar nuk është i përshtatshëm si tekst ligjor për arsye të ndryshme, veçanërisht për mungesën e saktësisë së tij. Mbështetësit argumentojnë se ky nuk ishte kurrë qëllimi ose qëllimi i Përkufizimit Të dakordësuar dhe se ai synohej në mënyrë të qartë të ishte tekst jo ligjërues i detyrueshëm që synon të japë udhëzime praktike për qeveritë për t'i mbështetur ato në përpjekjet e tyre për të parandaluar dhe kundërshtuar me efikasitet format e ndryshme të antisemitizmin.³²

³² Shih gjithashtu :Raporti Vjetor i ECRI-t 2018 § 17.

6. Janë shprehur gjithashtu shqetësime se përkufizimi i dakordësuar do t'i konsideronte të gjitha kritikant ndaj Izraelit si antisemite dhe do të mbyste fjalën e lirë, veçanërisht në kontekstin e protestave kundër shkëlqeve të të drejtave të njeriut të kryera nga autoritetet izraelite. Në të njëjtën kohë, përkufizimi i dakordësuar thekson se "kritika ndaj Izraelit e ngjashme me atë që bëhet kundër çdo vendi tjetër nuk mund të konsiderohet si antisemitike".

7. Në këtë kontekst, ECRI ka nënvizuar vazhdimisht se kritikant ndaj Izraelit nuk mund të konsiderohen në vetvete antisemitike, përderisa shprehen në të njëjtën mënyrë si kritikant ndaj shteteve të tjera. ECRI thekson fuqishëm se çdo përpjekje për të keqpërdorur Përkufizimin e dakordësuar dhe shembujt e tij për të ndrydhur ose stigmatizuar si antisemitike kritikant legjitime të Izraelit dhe politikave të tij, veçanërisht ndaj popullit palestinez dhe në kontekstin e pushtimit izraelit të territoreve palestineze, do të rrezikojë përpjekjet për të luftuar antisemitizmin dhe duhet të prandaj të refuzohet. Megjithatë, ECRI duhet të përsërisë se është e papranueshme që kritikant ndaj qeverisë izraelite përdoren për të nxitur urrejtje kundër të gjithë popullit hebre në Izrael dhe gjetkë, duke përfshirë akuzat për një "komplot hebre" në nivel global. Ky imazh, i cili ndërtohet mbi stereotipe shekullore, nxit pakënaqësi ndaj të gjithë hebrenjve.³³ Në raportet e tij vendore, ECRI ka vënë në dukje se rritjet e urrejtjes antisemitike janë parë shpesh në shumë vende evropiane në vazhden e dhunës së përtërirë në Lindjen e Mesme. Në diskutimin vijues publik, nevojës për të bërë dallimin midis kritikës ndaj veprimeve të Izraelit dhe shprehjes publike të urrejtjes ndaj popullit hebre dhe racizmit ndaj tyre në përgjithësi i vihet theks i pamjaftueshëm.³⁴ Institucionet hebraike, si sinagogat, qendrat komunitare dhe varrezat, shpesh vandalizohen, edhe si reagim ndaj ngjarjeve në Lindjen e Mesme. Pikëpamja se sulmet ndaj personave dhe pronës hebreje mund të konsiderohen si reagime të justifikueshme ndaj politikave ose veprimeve të qeverisë izraelite, për fat të keq, është e përhapur dhe jo vetëm nga anëtarët e grupeve ekstremiste.³⁵

8. Duke mbajtur parasysh vëzhgimet e mësipërme, ECRI mirëpret përkufizimin e dakordësuar jo-ligjor të IHRA-s për antisemitizmin në sensin që ai ndihmon dhe promovon një kuptim më të mirë të antisemitizmit. Veçanërisht, Përkufizimi i dakordësuar bazohet te koncepti që përfshin edhe forma të ndryshme bashkëkohore antisemitizmi, pa u përpjekur të delegjitimojë kritikant ndaj Izraelit aq sa që ky i fundit të respektohet sipas të njëjtave standarde si çdo shtet tjetër. Edhe pse nuk është një përkufizim i përfshirë në një traktat ndërkombëtar, ose i destinuar për t'u përdorur në proceset gjyqësore, dhe as nuk përfaqëson një përkufizim akademik të miratuar në mënyrë universale, ECRI konsideron se ai mund të jetë një mjet pozitiv dhe i inkurajon shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që ta marrin parasysh atë, veçanërisht në fushat e mbledhjes së të dhënave, arsimimit dhe ndërgjegjësimit.

³³ [:Raporti vjetor i ECRI-t 2019](#) § 14.

³⁴ [:Raporti vjetor i ECRI-t 2014](#) § 13.

³⁵ [:Raporti vjetor i ECRI-t 2018](#) § 16.

SHTOJCA II

Përkufizimi i dakordësuar i Antisemitizmit i Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) (miratuar nga seanca plenare e IHRA-s më 26 maj 2016)

“Antisemitizmi është perceptim i caktuar për hebrejtë, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit drejtohen ndaj individëve hebrej ose johebrej dhe/ose pronës së tyre, ndaj institucioneve të komunitetit hebre dhe objekteve fetare.”

Si drejtim për punën e IHRA-n, shembujt e mëposhtëm mund të shërbejnë si ilustrime:

Manifestimet mund të përfshijnë shënjestrimin e shtetit të Izraelit, i konceptuar si kolektivitet hebre. Megjithatë, kritika ndaj Izraelit e ngjashme me atë që bëhet kundër çdo vendi tjetër nuk mund të konsiderohet si antisemitike. Antisemitizmi shpesh i akuzon hebrejtë për komplot për të dëmtuar njerëzimin dhe shpesh përdoret për të fajësuar hebrejtë se "pse gjërat shkojnë keq". Ai shprehet në të folur, në të shkruar, në forma vizuale dhe veprime, si dhe përdor stereotipe të këqija dhe tipare negative të karakterit.

Shembujt bashkëkohorë të antisemitizmit në jetën publike, media, shkolla, vendin e punës dhe në sferën fetare, duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Thirrjen, ndihmën ose justifikimin e vrasjes ose dëmtimit të hebrenjve në emër të një ideologjie radikale ose një pikëpamjeje ekstremiste fetare.
- Bërjen e akuzave mashtruese, çnjerëzore, demonizuese ose stereotipike për hebrejtë si të tillë ose për fuqinë e hebrenjve si kolektiv - siç është, veçanërisht, por jo ekskluzivisht, miti për një komplot hebre botëror ose për hebrejtë që kontrollojnë median, ekonominë, qeverinë ose institucione të tjera shoqërore.
- Akuzimin e hebrenjve si popull përgjegjës për keqbërje reale ose imagjinare të kryera nga një person ose grup i vetëm hebre, apo edhe për veprime të kryera nga johebrej.
- Mohimin e faktit, fushëveprimit, mekanizmave (p.sh. dhomat e gazit) ose qëllimshmëria e gjenocidit të popullit hebre nga Gjermania Nationale Socialiste dhe nga mbështetësit e bashkëpunëtorët e saj gjatë Luftës së Dytë Botërore (Holokaustit).
- Akuzimin e hebrenjve si popull, ose Izraelin si shtet, për shpikjen ose ekzagjerimin e Holokaustit.
- Akuzimin e qytetarëve hebrej se janë më besnikë ndaj Izraelit, ose ndaj prioriteteve të supozuara të hebrenjve në mbarë botën, sesa ndaj interesave të kombeve të tyre.
- Mohimin e të drejtën së popullit hebre për vetëvendosje, p.sh., duke pretenduar se ekzistenca e Shtetit të Izraelit është përpjekje raciste.
- Zbatimin e standardeve të dyfishta duke pretenduar prej tij sjellje të papritura apo të pakërkuara nga asnjë komb tjetër demokratik.
- Përdorimin e simboleve dhe imazheve të lidhura me antisemitizmin klasik (p.sh. pretendimet për hebrejtë që vrasin Jezusin ose shpifje gjaku) për të karakterizuar Izraelin ose izraelitët.
- Paralelizimi i politikës bashkëkohore izraelite me atë të nazistëve.
- Fajësimi i hebrenjve në mënyrë kolektive për veprimet e shtetit të Izraelit.

Veprat antisemitike janë penale kur përcaktohen si të tilla me ligj (për shembull, mohimi i Holokaustit ose shpërndarja e materialeve antisemitike në disa shtete).

Veprat penale janë antisemitike kur objektivat e sulmeve, qofshin ata njerëz apo pronë – të tilla si ndërtesat, shkollat, vendet e adhurimit dhe varrezat – zgjidhen pasi janë, ose perceptohen se janë hebrej ose të lidhur me hebrejtë.

Diskriminimi antisemitik është mohimi i mundësive ose i shërbimeve, që ofrohen për të tjerët, për hebrejtë dhe është i paligjshëm në shumë vende.

SHTOJCA III

Lidhjet me dokumentet e përmendura në pjesët I-III

Protokolli shtesë i Konventës për krimin kibernetik në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste ose ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike (CETS Nr. 189)
<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168008160f>

Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Udhëzimet e rishikuara për mbrojtjen e viktimave të akteve terroriste
<https://rm.coe.int/protection-of-victims-of-terrorist-acts/168078ab54>

Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Rezoluta 2309 (2019) për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore hebreje
<http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=28247>

Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Rezoluta 2106 (2016) për ripërtëritjen e angazhimit në luftën kundër antisemitizmit në Evropë
<http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=22716>

Këshilli i Evropës, Kuadri Referencë i Kompetencave për Kulturë Demokratike
<https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture>

Këshilli i Bashkimit Evropian, Deklarata 13637/20 për integrimin e luftës kundër antisemitizmit në fushat e politikave
<https://www.consilium.europa.eu/media/47065/st13637-en20.pdf>

Këshilli i Bashkimit Evropian, Deklarata 15213/18 për luftën kundër antisemitizmit dhe për zhvillimin e një qasjeje për sigurinë e përbashkët për të mbrojtur më mirë komunitetet dhe institucionet hebreje në Evropë
<https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15213-2018-INIT/en/pdf>

Këshilli i Bashkimit Evropian, Vendimi Kuadër 2008/913/JHA për luftën kundër disa formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë nëpërmjet ligjit penal
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32008F0913>

Rekomandimi nr. 1 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit, kseofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës
<https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no.1>

Rekomandimi nr. i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t (rishikuar) për organet e barazisë për të luftuar racizmin dhe intolerancën në nivel kombëtar
<http://rm.coe.int/ecri-general-policy-/16808b5a23>

Rekomandimi nr. 5 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër intolerancës dhe diskriminimit kundër myslimanëve

<https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no.5>

Rekomandimi nr. 6 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër përhapjes së materialeve raciste, ksenofobe dhe antisemitike përmes internetit

<http://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-6-on-combating-the-dissemination/16808b5a8d>

Rekomandimi nr. i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t (rishikuar) për legjislacionin kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racor

<https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-7-revised-on-national-legislatio/16808b5aae>

Rekomandimi nr. 10 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në dhe përmes arsimit shkollor

<http://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-10-on-combating-racism-and-racia/16808b5ad5>

Rekomandimi nr. 12 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në fushën e sportit

<http://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-12-on-combating-racism-and-racia/16808b5ae7>

Rekomandimi nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes

<http://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>

Raportet vjetore të ECRI-t

<https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/annual-reports>

ECRI, Hyrja historike (Përgatitur për 25 vjetorin e ECRI-t)

<https://rm.coe.int/historical-introduction-/1680972f42>

Udhërrëfyesi i ECRI-t për barazinë efektive

<https://rm.coe.int/ecri-roadmap-final-version-/168097e13d>

Opinioni i ECRI për Përkufizimin e dakordësuar të antisemitizmit të IHRA-s

<https://rm.coe.int/opinion-ecri-on-ihra-wd-on-antisemitism-2755-7610-7522-1/1680a091dd>

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore) (CETS Nr. 005)

https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf

Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunës (CETS nr. 116) <https://rm.coe.int/1680079751>

Parlamenti Evropian, Rezoluta e 1 qershorit 2017 për luftën kundër antisemitizmit https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0243_EN.html

Agjencia për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian, Përmbledhja e praktikave për krimet e urrejtjes <https://fra.europa.eu/en/theme/hate-crime/compendium-practices>

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cerd.aspx>

Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA), Deklarata e Forumit Ndërkombëtar të Stokholmit për Holokaustin <https://www.holocaustremembrance.com/about-us/stockholm-declaration>

IHRA, Përkufizimi i dakordësuar i Mohimit dhe Shtrembërimit të Holokaustit <https://www.holocaustremembrance.com/resources/working-definitions-charters/working-definition-holocaust-denial-and-distortion>

IHRA, Përkufizimi i dakordësuar i antisemitizmit <https://www.holocaustremembrance.com/resources/working-definitions-charters/working-definition-antisemitism>

IHRA, Njohja dhe luftimi i shtrembërimit të holokaustit – Rekomandimet për Politikën dhe Politikëbërësit <https://www.holocaustremembrance.com/resources/reports/recognizing-counteracting-holocaust-distortion-recommendations>

OSBE, Përfundime nga Kryesia e Zvicrës më 12-13 nëntor 2014, pas 10 vjetorit të Konferencës së Berlinit për antisemitizmin <https://www.osce.org/files/f/documents/9/0/126710.pdf>

OSBE, Deklarata për rritjen e përpjekjeve për të luftuar antisemitizmit <https://www.osce.org/mc/130556>

OSBE/ODIHR, Kuptimi i krimeve të urrejtjes antisemitike dhe adresimi i nevojave të sigurisë së komuniteteve hebraike: Një udhëzues praktik <https://www.osce.org/odihr/317191>

OSBE/ODIHR Instrumentin e informacionit kundër krimeve të urrejtjes <https://www.osce.org/odihr/INFAHCT>

OSBE/ODIHR Programi i trajnimit për prokurorët dhe krimet e urrejtjes (PAHCT) <https://www.osce.org/odihr/pahct>

OSBE/ODIHR Programi i trajnimit kundër krimeve të urrejtjes për zbatimin e ligjit

(TAHCLE) <https://www.osce.org/odihr/tahcle>

Protokolli nr. 12 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (CETS nr. 177)

<https://www.coe.int/en/web/conventions/search-on-treaties/-/conventions/rms/0900001680080622>

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 61/255, 2007

<https://undocs.org/en/A/RES/61/255>

Strategjia dhe Plani i Veprimit të Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes

https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/advising-and-mobilizing/Action_plan_on_hate_speech_EN.pdf

Plani i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Vendeve Fetare: Në Unitet dhe Solidaritet për Adhurimi të Sigurt dhe Paqësor

<https://www.unaoc.org/resource/united-nations-plan-of-action-to-safeguard-religious-sites/>

Plani i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm <https://www.un.org/counterterrorism/plan-of-action-to-prevent-violent-extremism>

Komentet e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për ngjarjen e nivelit të lartë të UNESCO-s për fuqinë e arsimit për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit: Çështja e antisemitizmit (Nju Jork, 26 shtator 2018)

<https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2018-09-26/secretary-generals-remarks-high-level-event-power-education>

Reporteri i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për lirinë e fesë dhe besimit, Raporti për Antisemitizmin i 20 shtatorit 2019

<https://undocs.org/A/74/358>

UNESCO, Edukimi rreth Holokaustit dhe parandalimi i gjenocidit: Një udhëzues politikash <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000248071>

UNESCO dhe OSBE/ODIHR, Adresimi i antisemitizmit në shkolla: Kurrikula e trajnimit <https://en.unesco.org/news/addressing-anti-semitism-schools-unesco-and-osce-launch-framework-curricula-teacher-trainers> dhe <https://www.osce.org/odihr/470712>

UNESCO dhe OSBE/ODIHR, Adresimi i antisemitizmit përmes arsimit – Udhëzues për politikëbërësit

https://www.osce.org/files/f/documents/8/0/383089_0.pdf

Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut

<https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>